



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

---

Numri i lëndës: 2020:188925  
Datë: 25.10.2022  
Numri i dokumentit: 03563955

**C.nr.603/2020**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, gjyqtari **Betim Behluli**, me bashkëpunëtoren profesionale **Adelina Çmega**, në çështjen juridike të paditësit I. S. nga Rahoveci, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i tij i autorizuar M. B. Avokat nga Rahoveci, kundër të paditurit M. S. nga Rahoveci, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i tij i autorizuar E. G. - G. Avokate nga Prizreni, për shkak të pengim posedimit, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor, dhe pas zbatimit të provave, më datën **10.10.2022**, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit **I. S.** nga Rahoveci, **SI ME BAZË**.

**VËRTETOHET SE** i padituri M. S., nga Rahoveci, e ka penguar paditësin I. S. në shfrytëzimin e qetë dhe të lirshëm të rrugës së përbashkët në pjesën e parcelës së të paditurit M. S. Nr.057773-2, ZK Rahovec, Komuna Rahovec në tërë gjatësinë e parcelës dhe në gjerësi prej 1,5m, në gjatësi 24.95m, e cila pjesë e parcelës është caktuar dhe është shfrytëzuar si rrugë e përbashkët nga momenti i ndarjes, në atë mënyrë i padituri ndërmjet datës 18 dhe 19 dhjetor 2020 në mënyrë arbitrare, kundërligjore, pa pëlqimin dhe dijeninë e pronarit dhe poseduesit faktik të fundit, ka filluar ndërtimin e murrin rrethues në gjerësi prej 0.30 m dhe lartësi 1.30m, andaj paditësin I. S. e ka penguar në posedim qetë dhe shfrytëzim të lirë të rrugës së përbashkët, me të cilin rast kryen akt të pengim posedimit në dëm të paditësit.

**URDHËROHET** i paditurit M. S. që në të ardhmen të përmbahet që në të njëjtën mënyrë ose mënyra të ngjashme ta pengoj paditësin në posedimin dhe shfrytëzimin e qetë dhe të lirë të rrugës së përbashkët.

**OBLIGOHET** i padituri M. S., që ta prish murrin rrethues të ngritur ne gjatësi prej 24.95m ne gjerësi prej 0.30m dhe lartësi 1.30m ndërmjet parcelës se tij dhe të paditurit dhe ta kthej në gjendjen e mëparshme të posedimit, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktvendim, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

**OBLIGOHET** i padituri M. S., që paditësit t'ia kompensoj të gjitha shpenzimet procedurale në shumë prej 1,486.00 €, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën ekzekutim të përbarimit ligjor.

**A r s y e t i m**

Paditësi I. S., ka ushtruar padinë dhe propozimin për masën e sigurisë kundër të paditurit M. S., për shkak të pengim posedimit, ka cekur se ndërmjet datës 18-19.12.2020, duke shfrytëzuar mungesën e paditësit i cili gjendet me pune të përkohshme në shtetet e jashtme me qëllim të pengimit dhe shfrytëzimit të lirë të rrugës së përbashkët, ndërmjet parcelave të tyre e hap kanalën dhe fillon ndërtimin e murrin në mes të rrugës në tere gjatësinë e parcelës dhe në gjerësi 1.5m.

Sipas kësaj çështje juridike gjykata ka caktuar disa seanca të shqyrtimit kryesore radhazi në të cilën është paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i paditësit Av. M. B., si dhe përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit Av. E. G.- G..

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit avokati M. B. ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë si dhe precizimit të padisë dhe kërkesëpadisë, paditësi dhe i padituri janë në relacion të afërm familjar – vëllezër, gjithashtu kanë edhe vëllezër të tjerë. Paditësi dhe i padituri dhe vëllezërit e tjerë në prezencë të atit në vitin 1996, kanë bërë ndarjen fizike të pasurisë së paluajtshme, përveç parcelave tjera, paditësit i ka takuar parcela nr.05773-1 në sipërfaqe 726m<sup>2</sup>, ndërsa të paditurit parcela nr.05773-2, në sipërfaqe prej 727m<sup>2</sup>, e cila ka qenë parcelë në tërësi, e cila pas ndarjes i ka takua nga ½ e kësaj parcele. Për shkak të pozitës së parcelës e cila ka dalje në rrugën kryesore të qarkullimit në drejtimin Rahovec – Prizren, në prezencë të atit dhe bashkë familjarëve të tjerë me qëllim të qasjes të parcelave të ndara për hyrje dhe dalje në rrugën kryesore është lënë rruga e përbashkët në parcelë nga parcela e paditësit dhe të paditurit me gjerësi me nga 1.5m dhe në gjatësinë e tërë parcelës, të cilën rrugë e kanë shfrytëzuar nga viti 1996 deri me 18-19.12.2020. Përkundër marrëveshjes dhe shfrytëzimit të rrugës mbi 20 vite, i padituri në mënyrë të një anshme me datën e lartcekur e hap kanalën dhe fillon ndërtimin e murrin me këto veprime ka kryer aktin e pengim posedimit dhe shfrytëzimit të lirë të rrugës, të gjitha këto do të vërtetohen edhe me provat të propozuara në padi, dëgjimi i dëshmitareve F. S. dhe S. S., me daljen e gjykatës me ekspertin që të behet shqimin në vend, të identifikimit dhe matjes të rrugës nga ana e ekspertit. I ka propozuar gjykatës që ti procedoj provat si në padi, ndërsa pas procedimit të provave ta aprovoj kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Meqenëse edhe në momentin e parashtrimin të padisë dhe propozimit, i padituri ka qenë duke i kryer punimet rreth hapjes së kanalit dhe ndërtimit të murrin, të cilët punimet kanë përfunduar, i ka propozuar gjykatës që të vazhdoj me zhvillimin e procedurës pasi që baza e kontestit është prishja e murrin, ndërsa lidhur me propozimin për masën e sigurisë i le gjykatës të vendos sipas dispozitave ligjore. Ndërsa me parashtrësën e datës 21.09.2022 bëri precizimin e kërkesëpadisë ashtu që në këtë çështje kontestimore i propozoi gjykatës që tani e tutje objekt i kërkesëpadisë të jetë vetëm shqyrtimi i padisë për pengim të posedimit, ndërsa ka tërhequr propozimin për masën e sigurisë të ushtruar me datën 24.12.2020, andaj i propozoi gjykatës që pa dëgjimin e palëve të marr aktvendim me të cilin vërtetohet se i padituri M. S. e ka penguar paditësin I. lidhur shfrytëzim të lirë të rrugës së përbashkët, në pjesën e parcelës së të paditurit nr.05773-2, në gjerësi prej 1.5 metra, në gjatësi prej 24,95m duke e ngritur murrin rrethues, në gjerësi prej 0.30m dhe lartësi mesatare prej 1.30m e cila pjesë është caktuar dhe shfrytëzuar si rrugë e përbashkët nga momenti ndarjes lidhur me të drejtën e shfrytëzimit për parcelën Nr.05773-1 në sipërfaqe prej 726m<sup>2</sup> ZK Rahovec, të urdhërohet i padituri të përmbahet pengimit të shfrytëzimit të lirë të rrugës së përbashkët në pjesën e parcelës së tij si dhe të obligohet ta prish murrin e ngritur në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, po ashtu në seancën e datës 10.10.2022 i ka propozuar që të dëgjohet në cilësi të dëshmitares edhe H. K. e lindur S., motra e palëve ndërgjyqëse, pasi që është prezent në gjykatë, si dhe i ka kërkuar shpenzimet procedurale sipas tarifave të OAK-së.

Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se seancat e zhvilluara në gjykatë procedimin e provave dhe deklaratave të dëshmitarëve S. S., M. I. e lindur S., N. S. përndryshe vëllezër dhe motra të palëve ndërgjyqëse dhe dëshmisë të babit të palëve ndërgjyqëse, ekspertizës së ekspertit të gjeodezisë F. B., foto dhe dokumentacioni të bashkangjitura është vërtetuar gjendja faktike se paditësi dhe i padituri bashkërisht me familjar të tjerë në vitin 1966 gjatë ndarjes së bashkësisë familjare dhe të paluajtshmërive Nr.733-1, në sipërfaqe prej 726m<sup>2</sup>, ndërsa të paditurit parcela Nr.773-2 me sipërfaqe prej 727m<sup>2</sup>, me marrëveshje ndërmjet parcelave të lartcekura është lënë rruga e përbashkët në gjerësi 3,5 apo me nga 1.5m nga të dy parcela. Prej momentit të ndarjes pjesët e parcelës janë shfrytëzuar si rrugë e përbashkët deri ndërmjet datës 18-19.12.2020, i padituri shkak të mosmarrëveshjeve në mënyrë të një anshme ndërton rrugë ndërmjet parcelave të tyre në rrugën e përbashkët me qëllim të pengimit dhe shfrytëzimit të lirë të rrugës për paditësin. Gjendja faktike u vërtetua nga të gjitha provat e proceduara: deklaratat e dëshmitareve, ekspertiza e ekspertit gjeometër F. B., fotot dhe shkresat tjera të lëndës, pra për fund i propozoi gjykatës që pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe deklaratave padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

I padituri M. S. përmes përfaqësuese se autorizuar Av. E. G. – G. ka ushtrua përgjigje në padi ndaj padisë për pengim posedim lidhur me shfrytëzimin e rrugës së përbashkët, në seancën përgatitore të datës 04.10.2021 ka deklaruar qëndron në tërësi pranë përgjigjes në padi duke theksuar se për palën e paditur nuk është kontestues fakti se paditësi me të paditurin janë vëllezër, nuk është kontestues as fakti se në vitin 1996 është bërë ndarja fizike sipas marrëveshjes gojore dhe fakti se parcela Nr.05733-1, në sipërfaqe prej 726 m<sup>2</sup> është parcela e paditësit, ndërsa parcela me Nr.05773-2 me sipërfaqe prej 727 m<sup>2</sup> është parcele në emër të paditurit M. S.. Për të paditurin nuk kontestuese rrethana e përshkruar në padi se me marrëveshje gojore në mes të këtyre parcelave është lënë rruga e përbashkët në gjatësinë e kësaj parcele dhe në gjerësi prej 3.5m nga 1.5m prej të dy parcelave që kjo hapësirë nga viti 1996 paska qenë në shfrytëzim të përbashkët të paditësit dhe të paditurit pa pengesa, i cili fakt nga shkresa të lëndës do të provohet se nuk ka ekzistuar. Kjo parcele nga viti 1996 nuk ka pasur rrugë, gjithmonë ka pasur të mbjella me kulturë bujqësore të misrit, i padituri nuk e konteston as faktin se e ka ndërtuar murrin pikërisht në këtë parcele, por i njëjti asesi nuk ka bërë kurrfarë pengim posedimi për arsye se me ndarjes e pasurisë nga i ati i paditësit dhe të paditurit sipas Kontratës Nr.LRP-3086 të datës 07.10.2015 nuk është theksuar fakti se ndërmjet këtyre parcelave do të jetë rruga e përbashkët. Po ashtu ka propozuar që në cilësi të dëshmitarit të ftohet babai i paditësit dhe të paditurit N.S. nga Rahoveci, ndërsa e ka kundërshtuar propozimin e përfaqësuesit të paditësit që në cilësi të dëshmitares të dëgjohet H. K. e lindur S., motra e palëve ndërgjyqëse. I propozoi gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pabazë.

Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se padia dhe kërkesa padia e paditësit ligjërisht janë të pabazuara dhe si të tilla duhen të refuzohen nga ana e gjykatës për arsye se: Nuk janë kontestuese fakti se paditësi dhe i padituri janë vëllezër, fakti se në vitin 1996 është bërë ndarja fizike e pasurisë me marrëveshje gojore ku paditësit i takon parcela Nr.05733-1, në sipërfaqe prej 726m<sup>2</sup>, ZK Rahovec, ndërsa të paditurit parcela me Nr.05773-2 me sipërfaqe prej 727 m<sup>2</sup>, ZK Rahovec. Për të paditurin është kontestuese fakti se me marrëveshje gojore ndërmjet këto dy parcela është lënë rrugë e përbashkët ndërmjet parcelave në gjatësinë parcelës dhe në gjerësi prej 3.5m me nga 1.5m prej të dy parcelave e që kjo nga viti 1996 ka qenë në shfrytëzim të përbashkët të paditësit dhe të paditurit dhe se nuk ka pasur pengesa ligjore, e që është vërtetuar nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë F. B. me ekspertizën e datës 29.12.2021, përmes fotove të bashkangjitura në ekspertizë është theksuar se nga viti 2001 deri në vitin 2012 nuk është vërejtur që ka pasur rrugë të përbashkët në mes të parcelave të palëve ndërgjyqëse. Fakti se i padituri e ka ndërtuar rrugën në pjesë të kësaj parcele nuk është kontestues, po asesi nuk qëndron

fakti se është bere pengim posedimi sepse kjo hapësirë nuk ka qenë asnjëherë rrugë, po pjese pronësore e të paditurit, ashtu sikurse është lënë me kontratën për ndarjen e pasurisë së paluajtshme me numër Nr. i LRP-se:3086 dhe numër te referencës 1133/2015, të datës 07.10.2015, ku me të njëjtën kontratë babi i palëve ndërgjyqëse ka vendosur që t'ua ndaj parcelat në fjalë, mirëpo në asnjë nen të kësaj kontrate nuk është theksuar pretendimi i paditësit që hapësira ndërmjet dy parcelave të jetë rrugë e përbashkët për faktin se nuk ka pasur marrëveshje gojore për rrugën për të cilën pretendohet. Fakti se ndërmjet këtyre parcelave nuk ka ekzistuar rruga nuk qëndron, sepse në këtë gjykatë është shqyrtuar si prove edhe lënda me numër CN.nr.28/2018 në Gjykatën Themelore Gjakove – Dega Rahovec e datës 22.07.2019, lënda jo kontestimore për rregullim dhe ripërtrim të mexheve, në të cilën janë rregulluar mexhet në mes paditësit dhe të paditurit ku edhe në atë kohë është dorëzuar ekspertiza ku theksohet se propozuesi M. S. është posedues i ligjshëm i parcelës kadastrale nr.05773-2, ZK Rahovec, me sipërfaqe 727 m<sup>2</sup> dhe këtë fakt e ka ditur edhe paditësi I. S. ku në atë kohë ka qenë në cilësinë e kunderpropozuesit, kjo vërteton fakti se paditësi ka pasur njohuri lidhur me mexhet e ndara ndërmjet palëve ndërgjyqëse, si dhe lidhur me ndërtimin e murrit, i padituri ka pasur leje mjedisore të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, po ashtu sa i përket deklaratave të dorëzuara në gjykatë të dhënat tek noteri të vëllaut S. S. dhe motrës M. I., e lindur S., e njëjta konsideron se nuk duhet falur besimin sepse kanë qenë të propozuar nga përfaqësuesi i palës paditëse që si dëshmitarë të paraqiten vëllezërit S. dhe F. S., të njëjtit nuk kanë dhënë asnjë deklaratë në gjykatë lidhur me objektin e kontestit në mes të palëve ndërgjyqëse, ku të njëjtëve nuk kemi pasur mundësi ti bëjmë asnjë pyetje me të cilat do të vërtetonim saktësinë e pretendimeve tona. Po ashtu deklaratimet janë pranuar nga gjykata si prova në fund të shqyrtimeve gjyqësore dhe asnjëherë nuk janë propozuar që të administrohen në shqyrtim gjyqësor.

Për të vërtetuar gjendjen faktike, gjykata i ka zbatuar këto prova: është bërë shikimi në certifikatën e pronësisë për parcelën kontestuese me nr. 5773-2, të datës 30.06.2021, ka bërë shikimin kontratës për ndarjen e pasurisë të datës 07.10.2015, ka bërë shikimin të aktvendimit për rregullimin e mexheve të kësaj gjykate me nr. CN.nr.28/2018 të datës 22.07.2019, ka bërë shikimin e ekspertizës së ekspertëve gjeometër A. K. dhe R. K. së bashku me skicën e terrenit të datës 31.07.2019, ka bërë shikimin e vendimit të lejes ndërtimore për ndërtimin e murit të datës 09.10.2020, ka bërë shikimin e ekspertizës të ekspertit gjeometër F. B. të datës 29.12.2021 së bashku me skicën e terrenit dhe skicat nga arkiva, si dhe ka bërë shikimin e deklaratave të vërtetuar pranë noterit, të dëshmitarëve S. S. dhe M. I., e lindur S., të dhëna me datë 27.07.2022.

Pas analizimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 7 dhe 8 të LPK-së, si dhe në bazë të bindjes së vetë të lirë, është konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe e njëjta është aprovuar.

Me shikimin në certifikatën së pronësisë të datës 30.06.2021 me nr. të parcelës 5773-2, vërtetohet se parcela në fjalë, në sipërfaqe prej 727 m<sup>2</sup> evidentohet në emër të M. S..

Me shikimin në kontratën për ndarjen e pasurisë së paluajtshme nr. 113/2015 të datës 07.10.2015, vërtetohet se M. S. i takon parcela nr 5773-2 në sipërfaqe prej 727 m<sup>2</sup>, ndërsa I. S. parcela me nr. 5773-1 në sipërfaqe prej 726 m<sup>2</sup>.

Me shikimin në aktvendimin nr. CN.nr. 28/2018 të datës 22.07.2019, vërtetohet se janë rregulluar dhe ripërtërirë mexhet në mes të parcelave të propozuesit këtu të paditurit dhe kunderpropozuesit këtu paditësit: Parcela Nr.5773-2 evidentohet në emër të M. S., ndërsa parcela nr. 5773-1 evidentohet në emër të I. S..

Me shikimin në ekspertizën e ekspertëve gjeometër A. K. dhe R. K. të datës 30.07.2019, si dhe skicën e terrenit për pjesë e parcelave kontestuese vërtetohet se janë rivendosur megjë në mes parcelës të propozuesit këtu të paditurit nr.5773-2, në sipërfaqe prej 727 m<sup>2</sup> dhe parcelës të kunderpropozuesit këtu paditësit nr. 5773-, në sipërfaqe prej 726m<sup>2</sup> me dimensionet si në ekspertizë.

Me shikimin në vendimin për lejen ndërtimore me nr. 165 të datës 09.10.2020, të lëshuar nga Kuvendi Komunal në Rahovec – Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, vërtetohet se M. S. i është lëshuar leja ndërtimore për punim të murit rrethues në parcelën me Nr.5773-2 ZK Rahovec.

Me shikimin në ekspertizën e ekspertit gjeometër F. B. prej datës 29.12.2021, si dhe skicën e terrenit vërtetohet se në emër të M. S. evidentohet parcela Nr.5773-2, në sipërfaqe 727m<sup>2</sup>, ZK Rahovec, ndërsa në emër të I. S. evidentohet parcela Nr.5773-, në sipërfaqe 726m<sup>2</sup> në emër të paditësit I. S., si dhe vërtetohet se pala e paditur në vitin 2020 ka ndërtuar murin e ri përreth megjës në gjatësi prej 24.95m, gjerësi 0.30m dhe lartësi 1.30m, me ndërtimin e murrin të ri nga ana e të paditurit është vështirësuar hyrja në pjesën e palës paditëse,.

Me daljen në vend në prezencën e gjykatës është bërë identifikimi i parcelës e cila është objekt i shqyrtimit dhe është konstatuar kjo gjendje faktike: pjesa e parcelës për të cilën pretendohet se është bërë pengim posedimi, shihet se me ndërtimin e murrin rrethues nga ana e të paditurit ndërmjet parcelës së paditësit dhe të paditurit vërtetohet se paditësi është penguar në shfrytëzim të lirë të rrugës nga ana e të paditurit, si dhe me këto veprime i padituri ka kryer aktin e pengim posedimit ndaj paditësit lidhur me shfrytëzim të lire dhe të qetë të rrugës se përbashkët.

Me leximin e deklaratës se dëshmitarit S. S. të vërtetuara pranë noterit A. B. nga Prizreni, pasi që i është tërheq vërejtja që të flasë të vërtetën me pasojat juridike, vërtetohet se i njëjti ka deklaruar se: ndërmjet parcelave të vëllezërve të tij, këtu palëve ndërgjyqëse është lënë rruga nga fillimi i hyrjes në parcelën në gjerësi prej 3m, me nga 1.5m të pjesëve të parcelave që i kanë takuar vëllezërve, me qëllim të hyrjes dhe daljes në parcelë, e gjitha kjo me marrëveshjen ndërmjet vëllezërve nga momenti i ndarjes në vitin 1996 palët ndërgjyqëse e kanë shfrytëzuar rrugën e përbashkët për hyrje dhe dalje në parcelë, në fund të muajit dhjetor të vitit 2020 i padituri M. S. me qëllim të pengimit të shfrytëzimit të rrugës së përbashkët në mes të parcelave ka ndërtuar murrin rrethues.

Me leximin e deklaratës se dëshmitares M. I. e lindur S., të vërtetuara pranë noterit A. B. nga Prizreni, pasi që i është tërheq vërejtja që të flasë të vërtetën me pasojat juridike vërtetohet se njëjta: ka deklaruar se ndërmjet parcelave të vëllezërve të saj, këtu palëve ndërgjyqëse është lënë rruga nga fillimi i hyrjes në parcelë gjerësi prej 3m, me nga 1.5m të pjesëve të parcela që i kanë takuar vëllezërve, me qëllim të hyrjes dhe daljes në parcele, e gjitha kjo me marrëveshjen ndërmjet vëllezërve nga momenti i ndarjes në vitin 1996 palët ndërgjyqëse e kanë shfrytëzuar pa pengesa rrugën e përbashkët për hyrje dhe dalje në parcelë, mirëpo në fund të muajit dhjetor të vitit 2020 i padituri M. S. me qëllim të pengimit të shfrytëzimit të lirë të rrugës së përbashkët në mes të parcelave ka ndërtuar murrin rrethues.

Në bazë të nenit 103 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDTS), *“personi i cili e ushtron pushtetin faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë”*. Me nenin 113 par. 1 të këtij ligji është e paraparë se *“nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkoj rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës...”*,

ndërsa me paragrafin 2 të tij ceket se “nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi, mund të kërkoj nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkoj mbrojtje gjyqësore”. Në lidhje me çështjen në fjalë, duke u bazuar në nenin 480 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), **gjykata është kufizuar vetëm në konstatimin dhe provimin e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit, pa u lëshuar fare në çështjen që kanë të bëjnë me të drejtën e posedimit, bazën juridike të posedimit, ndërgjegjshmërinë apo pandërgjegjshmërinë e posedimit.**

Duke i marr për bazë të gjitha provat e administruara dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse në këtë çështje kontestimore, gjykata konsideron se padia e paditësit duhet të aprovohet si në dispozitiv të këtij aktvendimi dhe atë para se gjithash duke i marr për bazë provat e administruara në këtë çështje kontestimore në bazë të cilave është vërtetuar se i padituri e ka penguar paditësin në posedimin e fundit faktik.

Gjykata i ka vlerësuar edhe prova tjera të administruara, mirëpo konsideroi se ato nuk janë relevante për vendosjen në mënyrë tjetër në këtë çështje juridike, pasi kemi të bëjmë me pengim posedimi, e jo me vërtetimin e të drejtës së pronësisë.

Bazuar në nenet, 101, 113 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi Pronësinë dhe të Drejtat sendore, nenit 480 të LPK-së, lidhur me nenin 142.3 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedural është mbështetur në dispozitën e nenit 452 të LPK-së, të cilët kanë të bëjnë përpilimin e padisë në shumë prej 78,00 Euro, precizimit të padisë shumë prej 78,00 Euro, për dhjetë (10) seanca gjyqësore në shumë prej 1,010 Euro, për taksat gjyqësore në shumë prej 30,00 Euro, si dhe për ekspertizë të gjeometrit në shumë prej 250,00 Euro, gjithsej 1,446.00 Euro.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,  
C.nr.603/2021, më: 10.10.2022**

**B. Profesionale  
Adelina Çmega**

**Gjyqtari  
Betim Behluli**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, ankesa paraqitet nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.